Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo
CAA
Nr. i prot. 2021/ZDP/244
Br.prot./Prot.Nr.
Faqe: 1 Kopje: - Datë: 30/08/2021
Stranica/Pages Kopija/Copy Datum/Date
Hyrës/ulazno/in
Dalës/izlazno/out X
Brendshëm/interno/internal
Prishtinë/Priština/Pristina

07/ZDP/VE/2021
Datë: 12 gusht 2021

Në mbështetje të nenit 3.4, 15.1, 21.2 dhe 61 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008), nenin 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura,

Pas hyrjes në fuqi të Rregullores (AAC) Nr. 06/2021 për ndryshimin e rregullores (AAC) 17/2017 në lidhje me sigurinë e pistës dhe të dhënat aeronautike,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

## V E N D I M

1. Shfuqizohet Publikimi Teknik – PT 24 për "Matjen dhe Vlerësimin e Karakteristikave të Fërkimit në Sipërfaqen e Pistës", versioni 2, i muajit qershor 2018.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Më datën 23 korrik 2021, Autoriteti i Aviacionit Civil ka nxjerrë Rregulloren (AAC) nr. 06/2021 për ndryshimin e rregullores (AAC) 17/2017 në lidhje me sigurinë e pistës dhe të dhënat aeronautike. Dispozitat e Rregullores (AAC) nr. 06/2021 ndër të tjera trajtojnë në mënyrë specifike edhe procedurat e standardet që kanë të bëjnë me matjen, vlerësimin dhe raportimin e gjendjes së sipërfaqes së pistës, të cilat standarde paraprakisht kane qenë të trajtuara përmes PT-24. Dispozitat e lartpërmendura janë të aplikueshme nga data 12.08.2021

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 3.4, 15.1, 21.2 dhe 61 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, nenin 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe Rregullores (AAC) Nr. 06/2021 për ndryshimin e rregullores (AAC) 17/2017 në lidhje me sigurinë e pistës dhe të dhënat aeronautike, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Bujar Ejupi**
Drejtor i Përgjithshëm